



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	14.03.2024
REFERENC-Ë:	23/578/MMPHI-DMMU
PËR/ZA/TO:	"Alfa Minerals and Alloys L.L.C" Sh.p.k. Pejë, Fabrikë për përfitimin e kromit të varfër, Gjakovë
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit "Alfa Minerals and Alloys L.L.C" Sh.p.k. Pejë, me Nr. Prot. 23/578/MMPHI.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

- Vendimi për Leje Mjedisore për operatorin "Alfa Minerals and Alloys L.L.C" Sh.p.k. Pejë për veprimtarinë: Fabrikë për përfitimin e kromit të varfër, Gjakovë

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelaria Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 23/578/MMPHI

Datë: 14.03.2024.

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 13 dhe nenit 9 paragrafi 1.4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Operatorit "Alfa Minerals and Alloys L.L.C" Sh.p.k. Pejë, pajiset me Leje Mjedisore për veprimtarinë: Fabrikë për përfitimin e kromit të varfër, Gjakovë me Nr. Prot. 23/578/MMPHI.
2. Operatori obligohet:
 - 2.1. Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
 - 2.2. Sistemi de-pluhurues të jetë funksional;
 - 2.3. Shfrytëzimi dhe shkarkimi i ujërave të bëhet ne përputhje me Lejet Ujore;
 - 2.4. Për sistemin menaxhues të mjedisit të ketë personin përgjegjës të profilit mjedisor;
 - 2.5. Të monitorohet në vazhdim emisionet në ajër dhe të raportohet në MMPHI, sipas legjislacionit në fuqi.

- 2.6. Pas përfundimit të aktivitetit të bëhet rehabilitimi i terrenit sipas përshtimit në aplikacion;
- 2.7. Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPHI;

A r s y e t i m

2. Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin është konstatuar se "Alfa Minerals and Alloys L.L.C" Sh.p.k. Pejë, për veprimtarinë: Fabrikë për përfitimin e kromit të varfër, Gjakovë me Nr. Prot. 23/578/MMPHI në ngastren me nr. 00116-1, zona kadastrale, Gjakovë, plotëson kriteret e parapara me Udhëzim Administrativ 04/2022/MMPHI, për Leje Mjedisore.

Operatori ka bashkangjitur dokumentet:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- Pëlqim Mjedisor me Nr. 20/4960/1-ZSP/ /20, të lëshuar me dt. 03.03.2021;
- Leje për aktivitetet e veçanta për bazën e betonit me Nr. 896/KPMM/2022, të protokolluar me Nr. Prot. 3909 të lëshuar me dt. 09.11.2022, me afat të vlefshmërisë deri me 03.11.2027;
- Pëlqim për ushtrimin e veprimtarisë, lëshuar nga Komuna e Gjakovës , me date: 20.10.2020, ref.06/zyrtarisht;
- Leje Ujore për shfrytëzimin e ujërave nëntokësore nga Pusi, me Nr.: 5670/21-ZSP-2022, të lëshuar me dt. 21.12.2022;
- Leje Ujore për shkarkimin e ujërave, me Nr.: 5669/21-ZSP-2022, të lëshuar me dt. 21.12.2022;
- Raporti i analizave të pluhurit total të depozituar nga Laboratori "Inkos" sh.p.k me Nr. prot.67 të dt. 07.03.2024

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vlerëson se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore.

Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, në përputhje me nenin 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së



Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Gjakovë;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së